



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:190014

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396788

**C.nr.273/2012**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.R. me numër personal .... nga Gjakova, të cilin me autorizim e përfaqëson D.N. avokat nga Prizreni, kundër të paditurit R.B. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson N.K. avokat nga Prizreni, për shkak të pagimin e borxhit, vlera e kontestit dyqind mijë euro (200,000.00 €), pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 13.09.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET në tërësi e bazuar** kërkesëpadia e paditësit G.R. nga Gjakova.
- II. DETYROHET** i padituri R.B. nga Prizreni, që paditësit, t'ia paguaj shumën prej njëqind mijë euro (100,000.00 €), në emër të borxhit për mos përmbushjen e kontratës numër .... të datës 11.02.2008, si dhe në emër të kamatës së kontraktuar nga data e rënies në vonesë, deri në arritjen e vlerës së detyrimit në shumë prej njëqind mijë euro (100,000.00 €), e në shumë të përgjithshme prej dyqind mijë euro (200,000.00 €), në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- III. DETYROHET** i padituri R.B. nga Prizreni, që t'ia paguajë paditësit G.R. nga Gjakova, shpenzimet procedurale dhe atë shumën në lartësi prej katërmijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre euro e shtatëdhjetë e pesë cent (4,493.75 €), në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi G.R. nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur padi kundër të paditurit R.B. nga Prizreni, të cilën e ka precizuar në fjalën përfundimtare të dorëzuar në shqyrtimin e datës 06.09.2023, për shkak të pagimit të borxhit me kamatën e kontraktuar, vlera e kontestit prej 200,000.00 €.

- 1. Pretendimet e palëve ndërgjyqjese.*

Sipas të cekurave në padi, paditësi në bazë të kontratës për shitblerjen e pjesës përkatëse të kompanisë Nr..... të datës 11.02.2008, ia kishte shitur dhe bartur të paditurit pjesën përkatëse të kompanisë “GE Group” SHPK Prizren, e cila pjesë ishte në pronësi të tij, për çmimin total prej .... euro, me detyrim që pagesën i padituri ishte dashur ta bëjë në pesë këste dhe atë përfundimisht me 31.12.2010. në këtë kontraste, ndërgjyqësit kanë caktuar edhe kamatën prej 10 %, në nivel vjetor, në rast se blerësi bie në vonesë në lidhje me pagesën e borxhit. I padituri deri më tani e ka shlyer vetëm pjesërisht detyrimin e tij ndaj paditësit në lidhje me shitjen e pjesës përkatëse të kompanisë dhe atë në shumë prej ..... euro, kurse ka mbetur pa e shlyer pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej .... euro. Mirëpo, i padituri edhe pse ka skaduar afati për shlyerjen e pjesës së pashlyer të borxhit prej ..... euro, nuk e ka përmbushur këtë detyrim të borxhit, por ai asnjëherë nuk e ka mohuar borxhin në fjalë. Andaj, nga gjykata ka kërkuar që pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë si të bazuar.

I autorizuari i paditësit edhe për gjatë seancave gjyqësore ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se Nga shqyrtimi gjyqësor dhe administrimi i provave në këtë çështje civile-juridike padyshim është vërtetuar i tërë referati i padisë e rrjedhimisht edhe baza e kërkesëpadisë e paditësit G.R. nga Gjakova. Ndërgjyqësit me qëllimin e bashkëpunimit afarist kanë bashkuar mjetet financiare dhe në vitin 2004 kanë themeluar subjektin juridik “GE Group” Sh.p.k., me seli në Prizren, nga e cila deri në fillim të vitit 2008, kanë arritur në vlerën e kapitalit në vlerën prej 1,395,285.00 €, sipas procesit të cilët ndërgjyqësit bashkërisht me punën e tyre e kanë akumuluar dhe vlerësuar. Ndërmjet palëve ndërgjyqëse është lidhur kontrata nr. .... datë 11.02.2008, për shitblerjen e aksioneve të kompanisë “GE Group” Sh.p.k., me seli në Prizren, nga e cila paditësi si bashkë aksionar me 50% të aksioneve ia ka shitur të paditurit në vlerën prej 241,776. 10 €, kjo sipas nenit 3 të kësaj kontrate e cila ka ardhur si rezultat i procesit të barazimit nr.01-2008/GEG, të datës 16.01.2008, si dhe në emër të kontributit të dhënë në bashkëqeverisje të subjektit juridik, paditësit do të i takojë vlera e përgjithshme prej 58,223.90 €, sipas nenit 5 të kësaj kontrate, e gjithsej në shumën prej ..... €, I padituri konform kontratës se lartcekur në bazë të transaksioneve bankare, e mbështetur sipas ekspertizës së datës 15.05.2023, të ekspertës financiare A.K. ka kryer gjithsej 5 transaksione bankare dhe 3 pagesa në para të gatshme, e cila arrin në vlerën prej ..... €, ndërkaq pjesa prej ..... €, ka ngelur e papaguar. Nga ekspertiza e ekspertës financiare A.K. e datës 15.05.2023, është konstatuar edhe bazën e kërkesëpadisë së paditësit, ashtu që i padituri në emër të borxhit të papaguar sipas kontratës ..... datë 16.01.2008, nuk ka paguar shumën prej ..... € dhe bazuar në nenin 10 të kësaj kontrate- sipas kamatës së dakorduar, është llogaritur shuma prej 123,671.23 €, e që konform nenit 380 të LMD, është përlllogaritur shuma në vlerën prej 1.... €, në emër kamatës, e cila ekspertizë përveç që është përpiluar në mënyrë profesionale e njëjta është edhe në harmoni me shkresat e lëndës. Po ashtu ka theksuar se sa i përket ekspertizës me nr.072/2021, të datës 02.06.2021, të ekspertit V.I., e njëjta ekspertizë është përpiluar së bashku me kundërpadinë, respektivisht pa ndonjë vendim të posaçëm të Gjykatës ( Përfaqësuesi i paditësit të paktën nuk e disponon), e cila është refuzuar nga ana e Gjykatës , andaj konsideron që përveç që e njëjta nuk është e përpiluar konform asnjë kërkesë, e njëjta është e palejuar të çmohet. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar, ashtu si i ka specifikuar në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim.

I padituri, përmes të autorizuarit të tij në përgjigjen në padi, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se i gjithë afarizmi në mes të ndërmartjeve dhe transaksioneve është kryer përmes bankave Raiffeisen Bank, BPB dhe KasaBank dhe nga dokumentacioni bankar shihet qartë se i padituri nuk ka asnjë borxh dhe obligim tjetër ndaj paditësit G.R. por përkundrazi i padituri ka paguar, ka ra në lajthitje nga paditësi duke nënshkruar dokumentet e ofruara nga paditësi me mirëbesim dhe pa verifikuar shënimet zyrtare bankare. Andaj gjykatës i ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

I autorizuari i të paditurit, edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me parashtrësën e datës 05.09.2023, ka deklaruar se Kompania Ge Group sh.p.k, është themeluar me bashkimin e dy kompanive ekzistuese dhe atë E.... Sh.P.K me pronar G.R. (tash pronar) dhe G.... Sh.P.K me pronar R.B. (tash jo pronar). Tutje ka shtuar se vlera prej 241,776.10 euro, në bazë të dokumentacionit bankar të cilën e posedon kompania Ge Group Sh.P.K, në procesin e barazimit Nr.01- 2008, e përpiluar në Prizren, me datë 16.01.2008, është vlerë fiktive e cila është bartur edhe në kontratën për shitblerjen e pjesës përkatëse të kompanisë nr.02-2008/GEG, e lidhur në Gjakovë, me datë 11.02.2008, ku përfaqësuesi i të paditurit i kërkon Gjykatës një ekspertizë shtesë, që të vërtetohet vlera investuese e cila figuron në procesin e barazimit Nr.01-2008/GEG, të përpiluar në Prizren, me datë 16.01.2008 nga G.R. Në rastin konkret dhe nga provat që janë administruar, gjegjësisht nga leximi i raporteve të dhëna nga dy ekspert financiar të angazhuar, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë me obligime të ndërsjellat komerciale të dy subjekteve afariste dhe se për rastin konkret si gjykatë kompetente është Gjykata Komerciale në Prishtinë. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar

## 2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar,

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: ekspertizën e ekspertizës financiare të punuar nga ekspertja A.K. të datës 15.05.2023, në këtë çështje kontestimore, e dorëzuar në gjykatë me datë 16.05.2023 dhe deklarimi i ekspertës në shqyrtimin e datës 04.07.2023; dëgjimi i paditësit G.R. në cilësi të palës në shqyrtimin kryesor të datës 04.07.2023; dëgjimi i të paditurit R.B. në cilësi të palës në shqyrtimin kryesor të datës 04.07.2023; kontratën për shitblerjen e pjesës përkatëse të kompanisë me nr. 02-2008/GEG, të lidhur me datë 11.02.2008, ndërmjet palëve ndërgjyqëse; procesin e barazimit me nr. 01-2008/GEG, të datës 16.01.2008, e nënshkruar nga palët ndërgjyqëse; urdhër pagesën me nr. 01-G/09, të datës 17.11.2009; raportin bankar për periudhën 2005-2007, si dhe për periudhën 16.02.2008, deri me 25.10.2010; kontratën mbi shitblerjen e aksioneve me nr. 03/08-07, të datës 07.02.2008, e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse; deklaratën mbi transferet themelore të datës 07.02.2008, e dhënë nga paditësi G.R.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqjese dhe provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

*Kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.*

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga leximi i ekspertizës financiare të punuar nga ekspertja A.K. të datës 15.05.2023, të dorëzuar në gjykatë me datë 16.05.2023, gjykata vërtetoi faktin se është bërë përlllogaritja e lartësisë së borxhit sipas kontratës ..... dhe procesit të barazimit, si dhe është bërë llogaritja e kamatë vonesës. Ekspertja gjatë llogaritjeve të bëra i ka trajtuar provat të cilat janë të nënshkruara nga të dy palët, e bazuar në dokumentet e prezantuara totali i kësteve të paguara sipas kontratës me numër 02-2008/GEG, të datës 11.02.2008, është ..... €, ndërsa obligimi i mbetur sipas kontratës së lartcekur është në lartësi prej ..... €, e po ashtu edhe kamata ligjore e llogaritur nga momenti i moskryerjes së obligimit ndaj kësaj kontrate ka arritur në lartësi prej 123,534.25 €, ndërsa bazuar sipas dispozitave të LMD, kamata pushon të rrjedh kur arrin lartësinë e borxhit kryesor. Andaj shuma totale e borxhit të papaguar është në lartësi prej ..... €, po ashtu edhe shuma e kamatës ligjore të papaguar është në lartësi prej .... €, e që arrin totalin për pagesë 200,000.00 € (më gjerësisht si në ekspertizën e datës 15.05.2023, cila gjendet në shkresat e lëndës).

Gjykata në shqyrtimin e datës 04.07.2023, ka bërë dëgjimin e ekspertës A.K. e cila ka deklaruar se ka pranuar të gjithë dokumentacionin e lëndës dhe e ka kontrolluar tërësisht, edhe ekspertizën paraprake dhe shkresat e lëndës, dhe konstatimet e saj janë gjetjet të cilat i ka bërë duke mos u bazuar në ekspertizën paraprake. Me rastin e përpilimit të ekspertizës është bazuar në procesin e barazimit të datës 16.01.2008, po ashtu edhe në kontratën për shitblerjen e pjesës përkatëse të kompanisë, me nr.02-2008/GEG, të datës 11.02.2008. Tutje ka shtuar se në procesin e barazimit janë të paraqitura të gjitha elementet financiare, obligimet dhe pasurit e ndërmarrjes GE Grup, deri më datën 16.01.2008, ndërsa në kontratën mbi shitblerjen e datës 11.02.2008, janë të paraqitura në mënyrë të detajuar obligimet të cilat duhet të jenë përmbushur nga të dy bashkëpronarët (më gjerësisht si në deklarinimin e ekspertës në shqyrtimin e datës 04.07.2023).

Gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 04.07.2023, ka bërë dëgjimin e paditësit G.R. në cilësi të palës, i cili ka deklaruar se “unë së bashku me të paditurin R.B. kemi bërë një marrëveshje për themelimin e një kompanie për ndërtimin e rrugëve, afarizmi ynë ka zgjatë diku 4 vite dhe një moment është kërkuar nga i padituri që ta ndërpresim afarizmin në kompaninë e krijuar nga ne “GE Grup”. Me qëllim të ndërprerjes së këtij bashkëpunimi është kërkuar që të bëhet procesi i barazimit në të cilën janë theksuar investimet, kapitali si dhe obligimet e kompanisë. Dua të i tregoj gjykatës se procesi i barazimit të GE Grup, i datës 16.01.2008, është bërë nga bashkëpronari tani i padituri R.B. po ashtu edhe kontrata mbi shitblerjen e pjesës përkatëse të kompanisë GE grup, ka ardhur si propozim i R. por është negociuar dhe në fund është pranuar nga dy palët me nënshkrimin tonë, ku si dëshmitarë kanë qenë edhe vëllezërit tonë Sh.R. dhe Z.B. Me këtë kontratë ne kemi përmbyllur komplet afarizmin që kemi pas mes veti, dua të theksoj se në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate unë kam pasur përvojë në biznes mbi 20 vite,

ndërsa i padituri më shumë se 20 vite. Po ashtu dua të theksoj se janë paguar 2/3 e borxhit sipas kontratës së datës 11.02.2008, ndërsa 1/3 nuk është paguar që nga ajo kohë”.

Gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 04.07.2023, ka bërë dëgjimin e të paditurit R.B. në cilësi të palës, i cili ka deklaruar se “kompania GE grup është themeluar me bashkimin e dy kompanive ekzistuese dhe atë E... me ish pronar G.R. dhe Grandi Sh.p.k me pronar R.B. Deri në vitin 2007, puna në GE Grup ka qenë korrekte me ish bashkëpronarin dhe kam pasur besim të plotë me të, për shkak të obligimeve të mëdhaja kreditore nga kompania GE Grup, ndaj bankave, mbi 1.5 milion euro, unë i kam lënë tri shtëpi në Prizren në hipotekë ndaj kreditorëve, ndërsa G.R. nuk ka pas asgjë për të lënë. Në fund të vitit 2007, unë e thirri bashkëpronarin G.R. për ti paguar obligimet që i kishim ndaj bankave si kompani, ku unë kam qenë shumë i rrezikuar për shkak të borxhit të madh të kompanisë, për shkak të hipotekave që i kisha lënë për kompaninë, G.R. pas 1 jave i tërheq nga llogaria e GE Grupit shumë prej .... me datë 15.11.2007, për shkak se ne vetëm sa i kishim acaruar raportet ndërmjet veti si bashkëpronar dhe pas këtij rasti unë kam ftuar G.R. dhe i kam kërkuar që të deklarohet se a dëshiron të merr kompaninë apo të tërhiqet. Nëse dëshiron që ta merr kompaninë pranë bankave të paraqet 3 hipoteka që i kisha lënë unë ti zëvendësoj me hipotekat e tij dhe të merr kompaninë në gjendjen që ishte duke mos më paguar mua asnjë cent. Ky nuk pranoi dhe deklaroi se dëshiron të tërhiqet nga kompania duke kërkuar që ti kthehen investimet që kishte bërë në GE Grup. Unë kërkoja nga ai të bëjë procesin e barazimit të cilin me administratorin e kompanisë e ka bërë G. të cilin ma ka ofruar ta nënshkruaj, të cilin e kam nënshkruaj pa e verifikuar të dhënat e paraqitura në të, njëherit e kam njoftuar se do të bëjë verifikimin e procesit të nënshkruar, ndërsa me datën 11.02.2008, nga avokati Teki Bokshi, është përpiluar kontrata për shitblerjen përkatëse të kompanisë. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate kam filluar që të i bëjë pagesat e parapara në të për paditësin G.R. Deri në vitin 2009 kam mundur që ti paguaj .... euro për G.R. ku pas kësaj kam kontrolluar procesin e barazimit ku kam kuptuar se i njëjti ka investuar në shumë prej 99.880.00 euro në kompani, ndërsa në kontratën për shitblerjen dhe në procesin e barazimit i njëjti ka theksuar se ka investuar në kompani shumë 241.776.10 euro. E cila del vlerë fiktive”.

Nga leximi i kontratës për shitblerjen e pjesës përkatëse të kompanisë me nr. 02-2008/GEG, të lidhur me datë 11.02.2008, ndërmjet palëve ndërgjyqëse, gjykata vërtetoi faktin se lëndë e kësaj kontrate shitblerja e pjesës së bashkëpronësisë së Kompanisë “GE Group” sh.p.k. Kjo kontratë është bazuar në Procesin e Barazimit nr. .... të datës 16.02.2008, ashtu që bashkëpronari G.R. ia shet pjesën e tij të bashkëpronësisë bashkëpronarit tjetër R.B. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate palët janë dakorduar që vlera totale e shitjes është në lartësi prej 241,776.10 euro, të cilën pagesë sipas nenit 4 palët janë dakorduar që të bëhet me këste, kurse sipas nenit 5 palët kontraktuese janë marrë vesh që shitësit, në rastin konkret këtu paditësit, të i kompensohet vlera shtesë prej 58,223.90 €, në emër të shpërblimit për angazhim dhe kontribut të deritanishëm në “GE Group” sh.p.k, e cila vlerë duhej të paguhej me datë 31.12.2010.

Nga leximi i procesit të barazimit me nr. .... të datës 16.01.2008, të nënshkruar nga palët ndërgjyqëse, gjykata ka konstatuar se me datën 16.02.2008, palët ndërgjyqëse kishin përpiluar një proces barazimi që ka përfshirë periudhën e afarizmit të ndërmarrjes nga momenti i themelimit të saj, e deri në momentin e nënshkrimit, duke paraqitur në mënyrë tabelore pasqyrën

e investimit të realizuara nga “GE Group” sh.p.k, pasqyrën e pjesëmarrjes së bashkëpronarëve në investimet e “GE Group” sh.p.k dhe pasqyrën e obligimeve nda bankave, datë 16.01.2008.

Nga leximi i urdhër pagesës me nr. 01-G/09, të datës 17.11.2009, gjykata konstatoi faktin se me datë 17.11.2009, këtu paditësi kishte bërë pagesë në lartësi prej 30,000 euro.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë leximin e raportit bankar për periudhën 2005-2007, si dhe për periudhën 16.02.2008, deri me 25.10.2010, në të cilat janë paraqitur transferet bankare lidhur me pagesat e kryera nga këtu i padituri ndaj paditësit, e të cilat raporte janë vlerësuar edhe nga ekspertja lidhur me nxjerrjen e mendimit të saj në ekspertizën e datës 15.02.2023.

Nga leximi i kontratës mbi shitblerjen e aksioneve me nr..... të datës 07.02.2008, e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse, gjykata konstatoi faktin se me datë 07.02.2008, ndërgjyqësit kishin lidhur kontratën lënda e të cilës ishte shitja e aksioneve të “GE Group” sh.p.k, me numër të aksioneve 447.5 dhe për shumën totale të vlerës së aksioneve 44,750.00 €.

Nga leximi i deklaratës mbi transferin e mjeteve themelore të datës 07.02.2008, gjykata vërtetoi faktin se paditësi G.R. kishte deklaruar se me vullnet e bën bartjen dhe transferin e mjeteve themelore të regjistruara në emër dhe në pronësi të “GE Group” sh.p.k, tek pronari i vetëm, këtu i padituri R.B.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në këtë drejtim me nenin 10, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve(LMD), i datës 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur palët ndërgjyqëse kanë nënshkruar kontratën për shitblerjen e pjesës përkatëse të kompanisë Nr.02-2008/GEG, të datës 11.02.2008, është paraparë që *“Pjesëmarrësit e qarkullimit i rregullojnë lirisht marrëdhëniet e detyrimeve, por nuk mund ti rregullojnë në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregullimit shoqëror, me dispozitat e detyrueshme dhe me moralin e shoqërisë socialiste vetëqeverisëse.”*, kurse në nenin 17 të po këtij ligji, është paraparë se *“Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, përgjegjës për përmbushjen e tij...”*. Kurse në nenin neni 262 par 1 të po këtij ligji thuhet se *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij...”*.

Po ashtu me nenin 7.1 të LPK-së është paraparë se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa me nenin 7.2 të po këtij Ligji decedivisht ceket se *“Gjykata është e autorizuar ti vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuara në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”*.

Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara, rezulton se për asnjërin palë nuk ishte kontestuese faktin me paditësi me të paditurin, me datë 11.02.2008, kanë lidhur

kontratën me numër 02-2008/GEG, për shitblerjen e pjesës së bashkëpronësisë së Kompanisë “GE Group” sh.p.k, ku paditësi G.R. ia kishte shitur pjesën e tij të bashkëpronësisë bashkëpronarit tjetër këtu të paditurit R.B. Po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se palët ndërgjyqëse me datë 16.01.2008, kishin përpiluar procesin e barazimit duke përfshirë periudhën e afarizmit të ndërmarrjes nga momenti i themelimit të saj, e deri në momentin e nënshkrimit. Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse kishte mbetur fakti se sa ishte lartësia e borxhit sipas kontratës së lartcekur të shitblerjes dhe sipas procesit të barazimit të nënshkruar nga palët ndërgjyqëse, si dhe sa ishte lartësia e kamatëvonesës, e përcaktuar sipas kontratës së datës 11.02.2008.

Gjykata, konstatoi faktin se palët ndërgjyqëse, fillimisht kishin përpiluar procesin e barazimit me nr. 01-2008/GEG, të datës 16.01.2008, ku kishin përfshirë periudhën e afarizmit të ndërmarrjes “GE Group” Sh.P.K, nga momenti i themelimit të saj, e deri në momentin e nënshkrimit, duke paraqitur në mënyrë tabelore pasqyrën e investimit të realizuara nga “GE Group” sh.p.k, pasqyrën e pjesëmarrjes së bashkëpronarëve në investimet e “GE Group” sh.p.k dhe pasqyrën e obligimeve ndaj bankave, të cilin raport e kishin nënshkruar të dy palët ndërgjyqëse dhe bazuar në këtë raport-proces të barazimit të njëjtit kishin përpiluar kontratën me nr. .... të datës 11.02.2008. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate palët ishin dakorduar që vlera totale e shitjes është në lartësi prej 241,776.10 euro, të cilën pagesë sipas nenit 4 palët janë dakorduar që të bëhet me këste dhe kësti i fundit është përcaktuar me datë 31.12.2009, kurse sipas nenit 5 palët kontraktuese janë dakorduar që shitësit, në rastin konkret këtu paditësit, të i kompensohet vlera shtesë prej 58,223.90 €, në emër të shpërblimit për angazhim dhe kontribut të deritanishëm në “GE Group” sh.p.k, e cila vlerë duhej të paguhej me datë 31.12.2010. Shuma totale të cilën duhej ta paguante i padituri bazuar në këtë kontratë arrinte lartësinë prej ..... euro, e po ashtu palët ndërgjyqëse ishin dakorduar se në rast të dështimit të pagesës brenda afatit të caktuar, këtu i padituri do të paguante kamatën vjetore prej 10 %.

Për vërtetimin e saktë të shumës të cilën nuk e kishte bërë i padituri, e po ashtu edhe për llogaritjen e kamatëvonesës, gjykata kishte aprovuar propozimin e paditësit për nxjerrjen e ekspertizës financiare nga e cila ka vërtetuar faktin se totali i kësteve të paguara sipas kontratës me numër ..... të datës 11.02.2008, është ..... €, ndërsa obligimi i mbetur sipas kontratës së lartcekur është në lartësi prej .... €, e po ashtu edhe kamata ligjore e llogaritur nga momenti i moskryerjes së obligimit ndaj kësaj kontrate ka arritur në lartësi prej .... €, ndërsa bazuar sipas dispozitave të LMD, kamata pushon të rrjedh kur arrin lartësinë e borxhit kryesor. Andaj shuma totale e borxhit të papaguar është në lartësi prej ..... €, po ashtu edhe shuma e kamatës ligjore të papaguar është në lartësi prej ..... €, e që arrin totalin për pagesë ..... €. Ekspertizës së lartcekur, gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që e njëjta është e punuar në mënyrë profesionale dhe bazuar në të gjitha dokumentet të cilat janë të nënshkruara nga të dy palët dhe nga dokumentacioni financiar i cili gjendet në shkresat e lëndës sa i përket pagesave të bëra.

Gjykata, i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurit të paraqitur në deklarinimin e tij pranë kësaj gjykate, si dhe në fjalën përfundimtare se procesi i barazimit është nënshkruar pa u bërë verifikimi i të dhënave dhe se pas nënshkrimit të kontratës, e pas pagesës së shumës deri në ..... euro, ka konstatuar se vlera e paraqitur në procesin e barazimit është fiktive, mirëpo këto pretendime i vlerësoi si të pabazuara, pasi që paditësi gjykatës nuk i prezantoi asnjë provë

materiale se i njëjti e kishte kontestuar kontratën e lartcekur pasi që e ka bërë verifikimin e lartcekur. Ndërsa bazuar në të lartcekurat, përkatësisht ekspertiza e ekspertes financiare dhe transaksioneve bankare të cilat gjenden në shkresat e lëndës konstatohet fakti se i padituri, i kishte paguar paditësit shumën në lartësi prej ..... €, në emër të kontratës me numër 02-2008/GEG. Po ashtu i padituri gjykatës nuk i ofroi asnjë provë materiale se i njëjti kishte paguar shumën në lartësi prej ..... €, në emër të obligimit nga kontrata e cekur më lartë, po nga ekspertiza financiare dhe provat tjera të cilët gjenden në shkresat e lëndës, vërtetohet fakti se i padituri e ka paguar shumën në lartësi prej ..... €.

Gjykata vlerësoi se i padituri përpos pagimit të borxhit sipas kontratës së datës 11.02.2008, i njëjti duhet të paguaj edhe kamatën e paraparë dhe atë konform nenit 399 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve(LMD), i datës 1978, lidhur me kamatën e kontraktuar, ndërsa neni 401 i po këtij ligji parasheh se “*Kamata pushon të rrjedhë kur shuma e kamatave të rrjedha për pagesë por të papaguara arrijnë kryegjënë*”, kjo pasi që i padituri ka dështuar në përmbushjen e detyrimit sipas kontratës të lidhur në mes të këtu palëve ndërgjyqëse.

Sipas nenit 11 të LMD-së, palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Bazuar në dispozitat e LMD-së, i padituri ka qenë i detyruar t'i përmbush obligimet kontraktuese në tërësi ashtu siç është paraparë kontratën e datës 11.02.2008. Po ashtu i padituri në asnjë stad të procedurës nuk e kundërshtuar faktin se e ka bërë pagesën e plotë sipas kësaj kontrate, i njëjti gjatë dëgjimit të tij si palë, pranë kësaj gjykate ka deklaruar se “*Deri në vitin 2009 kam mundur që ti paguaj .... euro për G.R. ku pas kësaj kam kontrolluar procesin e barazimit ku kam kuptuar se i njëjti ka investuar në shumën prej 99.880.00 euro në kompani, ndërsa në kontratën për shitblerjen dhe në procesin e barazimit i njëjti ka theksuar se ka investuar në kompani shumën ..... euro. E cila del vlerë fiktive*”, duke nënkuptuar faktin se i njëjti e din se nuk e ka bërë pagesën e plotë sipas kontratës së lartcekur.

Gjykata në shqyrtimin e datës 31.07.2023, e ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditurit që në cilësi të provave të merren mjetet e investuara nga E.R. me pronar G.R. në GE grup, për periudhën 2005-2007, si dhe mjetet e huazuara nga Grand Sh.p.k të marrë nga G.R. për shkak se të njëjtat kanë qenë pjesë të shkresave të lëndës e po ashtu janë analizuar nga ekspertja me rastin e përpilimit të ekspertizës.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Për pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452 parag.1 lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TA-së, në të cilat janë përfshirë, përpilimi i padisë në shumë prej 325.00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 500.00 €, për përfaqësim në 7 seanca gjyqësore shumën prej 2,957.50 € (7x422.50), për përfaqësim në një seancë gjyqësore të shtyrë shumën prej 211.15 €, në emër të ekspertizës së ekspertit financiar shumën 500.00 €, apo shumën e përgjithshme prej 4,493.75 € (katërmijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre euro e shtatëdhjetë e



pesë cent). Gjykata e vlerësoi edhe kërkesën e paditësit që ti paguhen shpenzimet e procedurës për 1 seancë gjyqësore të shtyrë, mirëpo bazuar në shkresat e lëndës seanca e datës 07.06.2023, është shtyrë pa fajin e këtu të paditurit, andaj edhe nuk mund të ngarkohet për të njëjtat. Po ashtu edhe kërkesën e paditësit që në emër të precizimit të kërkesëpadsisë ti kompensohet shuma prej 325.00 €, gjykata e vlerësoi si të pabazuar, pasi që është obligim i vet palës paditëse që me rastin e paraqitjes së padisë të paraqesë edhe kërkesën e saj

Nga të lartcekurat dhe bazuar nenin 17 dhe nenit 262, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, e në lidhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:190014, 13.09.2023**

**G j y q t a r i**

---

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.